

V E N D I M
Nr.109, datë 13.3.1999

**PËR RRITJEN E SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE
NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të katërt të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të vendimit të Gjykatës Kushtetues nr.7, datë 26.4.1996 dhe të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.232, datë 10.4.1998, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", ndryshuar me vendimin nr.2, datë 10.2.1996 dhe me vendimin nr.232, datë 10.4.1998", shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar rritet në masën 8,7 për qind si vijon:

- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "a" nga 2 610 lekë në muaj bëhet 2 837 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "b" nga 2 088 lekë në muaj bëhet 2 270 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "c" nga 1 740 lekë në muaj bëhet 1 891 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 8 dhe 11 nga 870 lekë në muaj bëhet 945 lekë në muaj.
- Shpërblimi i menjëhershëm sipas pikës 13 nga 34 800 lekë bëhet 37 830 lekë

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondi i akorduar për këtë qëllim për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e shtetit për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko